Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

KOMUNIKATË

Ekipi i Kodifikimit dhe Nomenklaturës në mbështetje të mbikëqyrësve dhe regjistruesve nga distanca (ReKos 2024)

09 prill 2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka krijuar Ekipin e Kodifikimit dhe Nomenklaturës enkas për mbështetje nga distanca për të gjithë mbikëqyrësit dhe regjistruesit në terren për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos) 2024.

Ky ekip ka përgjegjësinë që të jap instruksionet e nevojshme në mënyrë që të dhënat e ReKos 2024 të jetë sa më cilësore për fushat e Kodimit dhe Nomenklaturës, që janë fusha shumë të rëndësishme për cilësinë e të dhënave.